



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:267483

Datë: 17.01.2022

Numri i dokumentit: 02612892

P.nr.1006/2019

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË - DEGA NË VUSHTRRI-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal, Gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen juridiko-penale kundër të pandehurit F. Z., për shkak të veprës penale Arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par. 1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.378/17, (2019:0134310), e dt.01.11.2019, më datën 17.01.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. HUDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë PP.II.nr.378/17, (2019:0134310), e dt.01.11.2019, dhe **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurit F. Z., për shkak të veprës penale Arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par. 1 të KPRK-së, për shkak dënimit me vendim të formës së prerë për çështjen e njëjtë penale, respektivisht zbatimit të dispozitës së nenit 4 - Ne Bis in Idem të KPPK-së.

II. Shpenzimet e procedurës penale mbesin në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.378/17, (2019:0134310), e dt.01.11.2019, kundër të pandehurit F. Z. për shkak të veprës penale Arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par. 1 të KPRK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, gjeti se ndaj të pandehurit të lartcekur, për veprën penale Arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par. 1 të KPRK-së, Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur dy aktakuza, dhe atë aktakuzën PP.II.nr.1594/19, të datës 09.09.2019 dhe aktakuzën PP.II.nr.378/17, të datës 01.11.2019.

Pas shqyrtimit të aktakuzave, gjykata gjeti se të dy aktakuzat kanë objekt të njëjtë, përkatësisht se i pandehuri me këto aktakuza, akuzohet për veprën penale Arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par. 1 të KPRK-së dhe koha e kryerjes së veprës penale nga i pandehuri është

e njëjtë, data 23.05.2017, e precizuar njëjtë në të dy aktakuzat e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Për çështjen penale sipas aktakuzën PP.II.nr.1594/19, të datës 09.09.2019, gjykata ka vendosur me aktgjykimin P.nr. 663/19, të datës 11.11.2019 dhe të pandehurin e ka shpallur fajtorë për veprën penale Arratisja e personit të privuar nga liria nga neni 405 par. 1 të KPRK-së, duke i shqiptuar të pandehurit dënim me burg, në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të pandehurit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumën prej njëmijë (1000) euro.

Duke vlerësuar të gjitha këto të lartcekura, gjykata çmon se çështja penale e ngritur me aktakuzën PP.II.nr.1594/19, të datës 09.09.2019 nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, përbën çështje penale të gjykuar (res judicata) dhe në pajtim me nenin 4 par. 1 të KPPK-së, përkatësisht parimin Ne Bis In Idem është përcaktuar se: *“Askush nuk mund të ndiqet dhe të dënohet për veprë penale nëse është liruar ose për të cilën është dënuar me vendim të formës së prerë, përkatësisht nëse procedura penale kundër tij është pushuar me vendim të formës së prerë të gjykatës ose aktakuza është refuzuar me vendim të formës së prerë të gjykatës”*.

Në bazë të nenit të nenit 358 paragrafi 1, pika 1.3 të KPRK-së është përcaktuar se, gjykata hedh poshtë aktakuzën në rastet kur ekzistojnë rrethana të cilat e pengojnë ndjekjen penale, e në rastin konkret gjykata hedh poshtë aktakuzën për shkak se çështja penale e ngritur me këtë aktakuzë përben çështje penale të gjykuar.

Në përputhje me nenin 454. par.1 të KPPK, është vendosur që shpenzimet e procedurës penale të ngelin në ngarkesë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Në bazë të nenit 4 par. 1 të KPRK-së dhe 358 par.1 pika 1.3 të KPPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.1006/19, datë 17.01.2022

Gjyqtar i vetëm gjykues
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, mund të ushtrohet ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës brenda afatit prej 5 (pesë) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit. Ankesa ushtrohet nëpërmes kësaj Gjykate në kopje të mjaftueshme.